



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.461/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Za Slobodu Pravdu i Opstanak me seli në Graçanicë, të parashtruar kundër subjektit politik „Lista Serbe me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.02.2025, merr këtë,

VE N D I M

Hedhet e pasafatshme ankesa Anr.461/2025, e datës 08.02.2025, e parashtruar nga subjekti politik, Za Slobodu Pravdu i Opstanak me seli në Graçanicë, kundër subjektit politik, Lista Serbe me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë Fushatës Zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 08.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.461/2025, të datës 08.02.2025, e parashtruar nga subjekti politik, Za Slobodu Pravdu i Opstanak me seli në Graçanicë, kundër subjektit politik, Lista Serbe me seli në Mitrovicë të Veriut, me të cilën pretendon se aktivistët e subjektit politik, Za Slobodu Pravdu i Opstanak, më 05.02.2025, gjatë vëzhgimit të aktiviteteve të subjekteve tjera politike, kanë vërejtur se përkrahës të subjektit politik Lista Serbe ne territorin e Komunës së Shtërpçës në disa lokacione (bashkangjitur fotografi) në vendet Gotovushë, Sevce, Jazhincë, Brezovicë, kanë vendosur postera në vende të paautorizuara, gjë që bie ndesh me kodet ligjore të subjekteve politike duke shfrytëzuar objektet për promovim dhe duke shkelur rregulloren e fushatës zgjedhore, pasi që kanë ngjitur postera në vende ku nuk është e paraparë për këtë. Parashtruesi i ankesës thekson se bazuar në dispozitat ligjore në fuqi dhe që lidhen me ciklin dhe rregullat zgjedhore, duke konsideruar se shkelja është bërë më 5 shkurt 2025 në orën 10:00, dhe te njëjtit kërkojnë nga PZAP-i që të marrë vendim ta aprovojë ankesën si të bazuar. Si dëshmi kane bashkangjitur fotografi të posterave të vendosur nga Lista Serbe në komunën e Shtërpçës në shtylla dhe rrethoja në disa lokacione.

Në përgjigjen në ankesë subjektit politik, Lista Serbe theksojnë se vetë denoncuesi pretendon se pamjet e dërguara si provë janë bërë më 5 shkurt 2025, ndërsa vetë ankesa është bërë më 8 shkurt 2025, përkatësisht në vetë ditën e zgjedhjeve, kur ishte në zhvillim e sipër heshtja parazgjedhore. Në ankesë theksohet se fotografitë, të cilat përbëjnë bazën e ankesës, janë bërë në datën 05.02.2025, ndërsa vetë ankesa është bërë më 9 shkurt 2025. Duke qenë se afati për paraqitjen e ankesës është paraparë me nenin 9, paragrafi 5, lidhur me paragrafët 5, 5. 5.7 dhe 5.8 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat për Parashtrimin dhe Vendosjen për Ankesave, i cili parasheh një afat për paraqitjen e ankesës prej 48 orësh. Vetë parashtruesi i ankesës e pranon se e ka paraqitur ankesën pas kohës, përkatësisht jashtë afatit të përcaktuar me ligj dhe rregullore, gjë që duket qartë nga vetë ankesa e ankuesit, që do të thotë se nuk është e pranueshme për procedura të mëtejshme dhe kërkojnë që të refuzohet e pabazuar.

Paneli pas vlerësimit paraprak të ankesës, vëren se ankesa është e pasafatshme.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga subjekti politik, Za Slobodu Pravdu i Opstanak, kundër Lista Serbe me seli në Mitrovicë të Veriut, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 39 paragrafi 3 i LZP-së, i cili përcakton se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqes ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe PZAP-i, do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga koha e pranimin të saj, si dhe neni 13, paragrafi 3, nen paragrafi 3.3 i Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, i cili përcakton se “PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim, nën paragrafi 3.3. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor.*

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën në PZAP, më datë 08.02.2025, , ku ka pretenduar se subjekti politik Lista Serbe është përgjegjës për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

Megjithatë, ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 39, paragrafi 3 i LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesës është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe se ankesa është dorëzuar më datë 08.02.2025, në ora 12.45, kurse pretendimet lidhur me shkeljet parashtruesi i ankesës thekson se kanë ndodhur me datën 05.02.2025, në ora 10.00, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Paneli gjeti se i njëjti është ushtruar pas afatit ligjor, dhe nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 39 paragrafi 3, nenit 115 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nen paragrafi 5.5 të Rregullës 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.461/2025 datë 10.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.